

FATMIRA MUSAJ

**RIORGANIZIMI I XHANDARMËRISË SHQIPTARE
(1925-1928)**

Xhandarmëria, si pjesë e rëndësishme e forcave të armatosura të shtetit shqiptar në vitet 1925-1939, ka tërhequr pak vëmendjen e historiografisë shqiptare. Ndaj në këtë artikull është bërë objekt trajtimi riorganizimi i xhandarmërisë në vitet 1925-1928. Pikërisht në këto vite u hodhën hapa të rëndësishëm për reformimin dhe konsolidimin e institucioneve shtetërore, për krijimin e legjislacionit shtetëror dhe zbatimin e ligjshmërisë në jetën e veprimtarinë shoqërore ku padyshim xhandarmëria luajti rol të rëndësishëm. Në situatën në të cilën ndodhej vendi në fund të dhjetorit 1924, ku ishte cenuar rëndë rendi dhe qetësia publike, padyshim midis faktorëve ndikues për gjendjen e vendit, edhe xhandarmëria kishte përgjegjësitë e saj.

Mbështetur në dokumente arkivore, në studim pasqyrohet gjendja në xhandarmërinë shqiptare në vitin 1925, problematika që e shoqëroi atë në këtë periudhë, analizohen faktorët që kushtëzuan veprimtarinë dhe penguan konsolidimin e saj. Gjithashtu evidentohen përpjekjet e masat e marra nga Ahmet Zogu dhe inspektorati i oficerëve britanikë, për riorganizimin dhe përgatitjen, për ta bërë atë një forcë efektive dhe profesioniste për vendosjen e rendit, ruajtjen e qetësisë dhe sigurimin e zbatimit të ligjit nga shtetasit.

* * *

Xhandarmëria ishte një organizëm i ri ashtu si vetë shteti shqiptar. Ajo u krijua fill pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave në janar të vitit 1913.¹ Në këtë vendim u përcaktua struktura organike, pagat përkatëse të personelit dhe organizimi territorial sipas ndarjes së re administrative. U krijuan tre batalione të cilat u vendosën përkatësisht në Vlorë, Elbasan e Berat. Ndërsa batalioni

¹ Kaliopi Naska, "Krijimi i forcave të rendit në shtetin shqiptar 1912-1914", në: *Rilindja Demokratike*, nr. 277, 13 janar 1993.

i Durrësit ishte vënë në shërbim të Esat Pashë Toptanit.² Sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, në korrik të vitit 1913, organizimi e drejtimi i xhandarmërisë iu ngarkua misionit holandez. Qeveria e Vlorës, në bashkëpunim me këtë mision, e plotësuan xhandarmërinë me katër detashmente, me një efektiv prej 300 xhandarësh secili. Krahas detyrës kryesore, me dekret të qeverisë së Vlorës në dhjetor 1913, xhandarmërisë iu ngarkua detyra e rëndësishme, për të marrë në dorëzim viset shqiptare të shkelura nga forcat pushtuese greke.³

Në vitet që pasuan arma e re e xhandarmërisë u pengua në ndërtimin e mëtejshëm, për shkak të situatës politike të brendshme dhe të jashtme që kaloi vendi deri në fillim të viteve '20 të shekullit të kaluar.

Domosdoshmëria e ringritjes dhe forcimit të forcave të armatosura, pra edhe e xhandarmërisë, u shtrua pas rimëkëmbjes së shtetit në vitin 1920. Deri në vitin 1924, u bënë përpjekje për t'i dhënë xhandarmërisë pamjen dhe funksionin e një force të organizuar. U hartuan një sërë ligjesh për ta vënë shërbimin e kësaj arme mbi baza ligjore si, në përcaktimin e strukturës, shpërndarjen territoriale sipas ndarjes së re administrative, përcaktimin e detyrave, të numrit të përgjithshëm të saj, etj. Por edhe gjatë viteve 1920-1924, mangësitë në organizimin dhe veprimtarinë e kësaj arme ishin të dukshme. Kjo evidentohet në raportin e prefektit të Gjirokastrës në shtator të vitit 1924, ku midis të tjerave theksonte se: "xhandarmëria nuk arriti të bëhej një forcë mbështetëse e fortë e fuqisë ekzekutive, shembull i nderit dhe disiplinës, një organ që të gëzonte besimin e plotë të popullit".⁴ Në gjendjen e saj kishin ndikuar faktorë të tillë si, mungesa e traditës dhe veçanërisht kujdesi i paktë i shtetit ndaj saj si në trajtimin financiar (paga të ulta dhe çrregullime në shpërndarjen e tyre), në veshmbathje, armatimin përkatës, në përgatitjen dhe arsimimin bashkëkohor të graduatëve e oficerëve, i cili do të ndikonte në zëvendësimin e mentalitetit të vjetër të trashëguar nga e kaluara, gjë që vihej re rëndom gjatë kryerjes së detyrës si të oficerët

² *Po aty.*

³ *Po aty.*

⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 152, viti (më tej: V.) 1924, Dosja (më tej: D.) 248, fl.27, Raport i Prefekturës së Gjirokastrës, mbi gjendjen në xhandarmëri, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: MPB), 3.9.1924. Aty thuhej se, paga e një graduati ishte 90 fr. ari dhe e një xhandari 60 fr. ari. Në raport bëheshin propozime konkrete mbi përmirësimin e strukturës së pagave në xhandarmëri.

ashtu edhe te xhandarët. Veç kësaj, lufta politike midis rrymave kundërshtare kishte përfshirë strukturat drejtuese të saj dhe e kishte çuar atë në devijim prej funksionit kryesor, duke i lënë vendin anarkisë, e pranishme edhe gjatë qeverisjes së Fan Stilian Nolit (qershor - dhjetor 1924).

A. Zogu, pas rikthimit në pushtet, nisi përpjekjet për të vënë në jetë një nga zotimet e deklaruara prej tij pas rrëzimit të qeverisë së Nolit, për të eliminuar anarkinë dhe për t'i rikthyer popullit qetësinë dhe rendin. Në fjalimin që mbajti para Kuvendit Kushtetues në janar 1925, ai nuk i kurseu kritikën ndaj forcave të armatosura në përgjithësi dhe xhandarmërisë në veçanti, të cilat ishin bërë palë me forcat politike në ngjarjet e qershorit 1924 në dëm të regjimit kushtetues dhe paralajmëroi për një reformim të plotë të tyre. Fajtoje për gjendjen në të cilën ndodhej vendi ai bëri xhandarmërinë, duke e cilësuar atë si “foleja e të gjitha të këqijave”. A. Zogu u angazhua për një riorganizim rrënjësor të saj.⁵ Kështu xhandarmëria pësoi të njëjtin fat si edhe ushtria⁶. Strukturat e saj u shpërndanë. Ngritja e strukturave të reja u krye nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila u kujdes që në radhët e saj të përfshiheshin graduatë e oficerë besnikë të regjimit.⁷

Kryesia e Republikës, Shtatmadhuria e Komanda e Përgjithshme e Forcave të Armatosura (KPFA), në fillim të vitit 1925, miratuan planin e hartuar nga organizatorët e huaj, Gustav Myrdac dhe koloneli Walter Francis Stirling, për riorganizimin e ushtrisë dhe të xhandarmërisë.⁸ Sipas këtij plani, xhandarmërisë, veç detyrës për sigurimin e rendit dhe të qetësisë në vend, iu shtua edhe ajo e ruajtjes së kufirit, detyrë të cilën deri

⁵ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 607, fl. 25, Telegram i prefekturës së Tiranës drejtuar MPB, Tiranë, mars 1925.

⁶ Për reformën në ushtri shih: Fatmira Musaj, “Riorganizimi i forcave të armatosura në Shqipëri (1925-1928)”, në: *Studime Historike*, 3-4, 2012, f. 131-154.

⁷ *AQSh*, D. 157, fl. 68, Sugjerim i zv/komandantit të qarkut të Elbasanit, Selman Çema, drejtuar MPB, Tiranë, 28.2.1925.

⁸ *Po aty*, F. 178, V. 1925, D. I-754, fl. 17, Kryesia e Republikës drejtuar Shtatmadhorisë. Komanda e Përgjithshme e Forcave të Armatosura (më tej: KPFA), vendime mbi organizimin e ushtrisë dhe xhandarmërisë, Tiranë, 21.12.1925. G. Myrdac dhe koloneli Stirling, ishin në Shqipëri qysh në vitin 1923 me kërkesë të shtetit shqiptar. Sipas kujtimeve të W.F. Stirling, *Safety Last*, D.S.O., M.C. Hollis and Carter, London 1953, f.124.

tani e kishte kryer ushtria.⁹ Për shkak të buxhetit të ulët financiar, numri i forcave të xhandarmërisë së qëndrueshme nuk i arrinte 2000 vetë.¹⁰ Me këtë efektiv xhandarmëria e kishte të pamundur realizimin e detyrave që i ishin caktuar. Prandaj, në këtë periudhë kalimtare por shumë të rëndësishme për regjimin, u pa e arsyeshme që atyre t'u shtoheshin edhe 9 kompani shëtitëse, të cilat u vunë nën komandën e xhandarmërisë.¹¹

Sipas këtij riorganizimi, xhandarmëria u nda në dy kategori: në xhandarmëri të qëndrueshme, që përbëhej me forca të rregullta të xhandarmërisë dhe, në kompani shëtitëse që përbëheshin me efektivë të rekrutuar me pagesë. Forcat e xhandarmërisë së qëndrueshme dhe kompanitë shëtitëse u shpërndanë në katër zona:

Zona e Veriut me qendër në Shkodër, me komandant Malo Bushatin, kishte në varësi rrethkomandat e Lezhës, Mirditës, Malësisë së Madhe, Dukagjinit.

Zonëkomanda e Peshkopisë, me komandant Muharrem Bajraktarin, përfshinte rrethkomandat Peshkopi, Bicaj, Krumë, Mat, Zerqan, Malësi.

Zonëkomanda e qendrës në Tiranë, me komandant Fiqiri Dinen, në varësi të saj ishin rrethkomandat e Tiranës, Krujës, Durrësit, Kavajës, Elbasanit, Gramshit, Beratit, Lushnjës, Fierit, Mallakastrës, Skraparit.

Zonëkomanda e Jugut, me komandant Hysni Demën, në varësi të së cilës ishin rrethkomandat e Gjirokastrës, Delvinës, Libohovës, Kurveleshit, Himarës, Vlorës, Tepelenës, Përmetit, Korçës, Leskovikut, Bilishtit, Pogradecit, Kolonjës.¹²

Në krye të zonëkomandave u caktuan persona besnikë të Zogut, që kishin kontribuar në mënyrë aktive për kthimin e tij në pushtet. Xhandarmëria kryente edhe funksionin e policisë pas shpërndarjes së kësaj të fundit.

Në kushtet kur dy forcat e armatosura, ushtria dhe xhandarmëria, ishin në ringritje, përballimi i një gjendjeje të jashtëzakonshme që mund

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *AQSH*, F. 152, V. 1924, D. 248, fl. 27, Raport i prefektit të Gjirokastrës drejtuar MPB, Tiranë, 3.9.1924.

¹¹ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 334, fl. 7, KPFA drejtuar MPB, Tiranë, 15.2.1925.

¹² *Po aty*, fl. 20-21, Njoftim i KPFA drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë (KPXH), Tiranë, 4.2.1925; *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, nr. 65, Fjala e A. Zogut, 21.1.1925, f. 889-891; *Gazeta e Korçës*, nr. 166, 24 shkurt 1925, f. 4, Mbi ndryshimet në xhandarmëri.

të kalonte vendi, vetëm prej njëres forcë, ishte i pamundur. Prandaj ishte parashikuar që në situata të tilla, ato të bashkëpunonin midis tyre. Realizimi i tij, u përcaktua në rregulloren për riorganizimin e xhandarmërisë, e cila hyri në fuqi më 15.2.1925.¹³ Në rregullore përcaktoheshin kompetencat dhe detyrat e secilës komandë, pikat e bashkëpunimit në procesin e rekrutimit e të mobilizimit në raste gatishmërie, për çështje të armatimit, të municioneve sidomos me intendencën e të dy palëve. Përveç këtyre, komandës së xhandarmërisë i njiheshin kompetenca të plota për personelin e saj si, përshkrim (biografi), emërim, gradim, transferim, dënimin, lirim, lejet dhe pensionet e tyre.¹⁴

Në kushtet e rritjes së pakënaqësisë në krahina të ndryshme të vendit ndaj politikave fiskale të qeverisë gjatë vitit 1925 dhe mundësisë për shfrytëzimin e saj nga elementët opozitarë, lindi nevoja për shtimin e forcave të xhandarmërisë si në nënprefekturën e Dukagjinit, të Kavajës, Lushnjës, në prefekturat e Korçës, Vlorës, Beratit etj.¹⁵ Por, Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë (KPXH), për shkak të mungesave financiare u kërkoi zonëkomandave të shfrytëzonin sa më me efektivitet forcat ekzistuese deri në shtim të buxhetit.¹⁶ Përjashtim u bë vetëm për zonën e Shkodrës, ku sipas informacioneve, gjendja paraqitej shumë e trazuar. Aty u dërgua një forcë shtesë prej 466 oficerësh e xhandarësh.¹⁷

Xhandarmëria në vitin 1925

Të dhënat dokumentare të gjysmës së parë të vitit 1925, dëshmojnë se pavarësisht riorganizimit, forcat e xhandarmërisë nuk po arrinin rezultatet e pritshme për vendosjen e rendit. Përkundrazi, veprimet abuzive dhe antiligjore të xhandarëve dhe kompanive shëtitëse, po shkaktonin shtimin e pakënaqësisë së popullit ndaj regjimit. Në këtë realitet ndikuan disa faktorë si, mundësitë e pakta financiare të shtetit në caktimin e buxhetit të pamjaftueshëm financiar, pagat e ulëta dhe

¹³AQSH, F. 235, V. 1925 D. 329, fl. 8, Rregullore mbi reformimin e riorganizimin e xhandarmërisë, Tiranë, 4.2.1925.

¹⁴Po aty.

¹⁵Po aty, F. 152, V. 1925, D. 151, fl. 113, Telegram i prefekturës së Vlorës drejtuar MPB, Vlorë, 5.3.1925; po aty, V. 1925, D. 607, Telegram i MPB drejtuar KPFA-së, Tiranë, 26.1.1925; po aty, V. 1925, D. 14, fl. 4, 17, 21, 33.

¹⁶Dielli, 2321(364), 3.2.1925, f. 1.

¹⁷AQSH, F. Komanda e Xhandarmërisë, V. 1925, D. 5, Telegram i Komandës së zonës Shkodër, 2.2.1925.

infrastruktura shoqëruese e dobët, mungesa e traditës, përzgjedhja e xhandarëve dhe oficerëve pa kriter duke vlerësuar më shumë besnikërinë ndaj regjimit dhe përfshirja në këtë forcë e efektivëve civilë, të cilët ishin pa përgatitjen përkatëse.

Këtë gjendje në trupën e xhandarmërisë e dëshmojnë të dhëna të shumta që u vinin organeve më të larta të vendit, ku shprehej pakënaqësia për sjelljen e xhandarëve dhe sidomos të oficerëve të kompanive shëtitëse në krahina të ndryshme. Në telegramin që prefekti i Beratit, I. Kryeziu i drejtonte Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), theksonte: "Aq të rënda janë bërë shkeljet e kompanive civile (shëtitëse) në Berat, sa përveç grabitjes në pronat e qytetarëve dhe prodhimet e fshatarëve, kanë filluar të përzihen në çështje nderi, sa gratë me frikë guxojnë të dalin."¹⁸ Po kështu, prefekti i Vlorës informonte se xhandarët e kompanive shëtitëse kishin kryer vepra të këqija, kishin rrahur popullin, kishin hyrë nëpër familje e grabitnin para. "Me kësi xhandarësh, shprehej ai, jo vetëm që s'ka për t'u ruajt qetësia, por ka me u përdhos më tepër."¹⁹ Njoftime të tilla vinin në MPB edhe nga krahinat e Lushnjës, Fierit dhe ato të Verilindjes. Aty denoncoheshin veprimet e komandantëve të xhandarmërisë, të cilët u kërkonin ryshfet tregtarëve, mallrat kontrabandë i sekuestronin dhe i shisnin për llogari të tyre duke shkelur të drejtat doganore.²⁰ Kompania shëtitëse në Verilindje sillej keq me popullin duke fyer e rrahur, veprime të cilat ndikonin në humbjen e simpatisë të popullit për regjimin.²¹ Gjithashtu, Komanda e KPXH-së u vu në dijeni edhe për shfrytëzimin e postit zyrtar nga ana e disa autoriteteve drejtuese të strukturave të xhandarmërisë, të cilët përdornin xhandarët për shërbime personale, duke cenuar kështu raportet midis kuadrove komandues me xhandarët e thjeshtë në kompanitë shëtitëse. Ata i përdornin xhandarët për punët në bujqësi në tokat e tyre, për shërbime familjare, etj.

¹⁸ *Po aty*, F. 152, V. 1927, D. 28, fl. 24, Telegram i prefektit të Beratit drejtuar MPB, Berat, 12.8.1927.

¹⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 151, fl. 89, Shkresë e prefektit të Vlorës drejtuar MPB, Vlorë 17.2.1925.

²⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1926, D. 187, fl. 78, Telegram i zv/prefektit të Fierit drejtuar prefektit të Beratit, Fier, 2.2.1926.

²¹ *Po aty*, fl. 190, Telegram i MPB, drejtuar komandantit të zonës së Lindjes, MPB, Peshkopi, 5.3.1926; *po aty*, V. 1927, D. 630, fl. 8, Telegram i MPB drejtuar nënprefekturës së Dukagjinit, Kodër Shëngjergj, Tiranë, 11.2.1927.

Këto dëshmi dhe ankesa u analizuan nga KPXH-ja. Veprime të tilla ajo i konsideroi si antiligjore. U drejtoi disa qarkore komandave të zonave, ku kërkonte forcimin e disiplinës në efektivat vartëse si dhe përdorimin e forcave të xhandarmërisë në përputhje me ligjet dhe rregulloret ushtarake të Republikës.²² U tërhoqte vëmendjen oficerëve, të cilët me ndërhyrjet dhe miqësitë e tyre, u bënë lëshime xhandarëve në kryerjen e detyrës, regjistronin si xhandarë persona të paafte e jashtë kriterëve të moshës, prej të cilëve nuk përfitohej kurrfarë shërbimi. KPXH-ja shprehte bindjen se, nëse eliminohehin dukuritë e mësipërme dhe mirëadministrohej fuqia aktive e xhandarmërisë, edhe me atë numër të vogël, ajo mund të siguronte qetësinë e të krijonte përshtypje të mirë në rajonet ku shërbente.²³ Por KPXH-ja u mjaftua vetëm me evidentimin e problemeve në xhandarmëri dhe nuk i shoqëroi ato me masa ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjit, duke lënë të hapur mundësinë e përsëritjes së tyre, gjë që çoi në rritjen e ankesave të qytetarëve dhe të pakënaqësisë së tyre në krahina të ndryshme të vendit.

Komandanti i xhandarmërisë së zonës së Verilindjes, Muharrem Bajraktari, shprehej se në efektivitetin e pamjaftueshëm të veprimtarisë së xhandarmërisë, ndikonte negativisht gjendja në të cilën ndodhej ajo. Në raportin drejtuar MPB-së, ai evidentonte mangësitë në uniformën zyrtare të xhandarëve. Ata ishin të pajisur me armatim të llojeve të ndryshme të rëna nga kalibri, të cilat ulnin cilësinë luftarake. Po ashtu vihej re edhe mungesa e municioneve. Kjo, sipas tij, e kishte çuar xhandarmërinë në paraqitjen e saj më të keqe para popullit duke ulur njëkohësisht edhe autoritetin e saj. “Është një organizim në formën e bashibozukëve, në formë bandash, që bën përshtypje të keqe dhe e prezanton shtetin para gjithkujt e sidomos para të huajve në postat kufitare.”²⁴ Për përmirësimin e gjendjes, ai kërkonte riparimin e ndërtesave të rrethkomandave, të cilat ishin pothuajse të shkatërruara.²⁵ Vëmendje të veçantë, M. Bajraktari i kushtonte mënyrës së pagesave të xhandarëve dhe oficerëve, gjë që kishte ndikuar negativisht te të gjithë

²² *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 14, fl. 75, Qarkore e KPXH drejtuar prefekturave, nënprefekturave, zonëkomandave; *po aty*, fl. 67.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D.17, fl. 3, Telegram i komandantit të zonës së Lindjes, kapiten M. Bajraktari drejtuar MPB, Peshkopi, 12.5.1925; *po aty*, V. 1925, D. 191, fl. 1, 4, Telegram i prefekturës Shkodër drejtuar MPB, 1.1.1925.

²⁵ *Po aty*.

oficerët. Ata ishin betuar se po të vazhdonte kjo gjendje “do të lëshojnë armët.”²⁶

Shpërndarja e pagave ishte problem në të gjithë administratën e shtetit në këtë periudhë, por më e ndjeshme ishte për xhandarmërinë, pasi ajo kishte të bënte me sigurinë publike dhe autoritetin e shtetit, si kushte të rëndësishme për qeverisjen e vendit. Veç nivelit të ulët të pagave, xhandarët vuanin edhe nga shpërndarja e çrregullt e tyre. Kishte raste kur pagat vonoheshim deri në 8 muaj. Kjo ishte rrjedhojë jo vetëm e buxhetit financiar të kufizuar që caktohej për xhandarmërinë, por edhe i veprimtarisë abuzive e arbitrare të nëpunësve që u ishte ngarkuar kjo detyrë, mangësive të Ministrisë së Financave në ushtrimin e kontroleve për zbatimin e disiplinës financiare, etj. Ata nuk e administronin fondin e pagave në bazë të ligjeve dhe rregullave financiare por sipas një mentaliteti të deformuar dhe të trashëguar nga periudha e Perandorisë Osmane, kur në kushtet e mungesës së zbatimit të ligjit dhe rregullit, dilte në pah autoritarizmi dhe subjektivizmi i zyrtarëve në ushtrimin e detyrave funksionale. Rasti më evident ishte lëvrimi i fondit prej 30.000 fr.ar që qeveria në mars 1925, e dërgoi për të paguar pagat e prapambetura të xhandarëve të Lumës e të Dibrës. Megjithëse, ky fond u shoqërua me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, KPXH-ja konstatonte se, nëpunësit e intendencës nuk ua ndanë xhandarëve, por në mënyrë arbitrare, paguan nëpunës e personel që e kishin parë më të “arsyeshëm”.²⁷ Ky ishte një fenomen i përhapur pothuajse në të gjithë prefekturat e vendit.²⁸

Veç këtyre dukurive, shpërndarja e strukturave të vjetra të xhandarmërisë kishte krijuar mundësi abuzimi për financierët dhe intendentët. Ata mbanin në listëpagesat emrat e xhandarëve të liruar, pagat e të cilëve i përvetësonin duke bërë dëftesa false me shenja të rremë të gishtave. Ky veprim e kishte çuar deficitin e arkës së xhandarmërisë në Peshkopi, në 7000 fr. ar.²⁹

Nënprefekti i Peshkopisë, Abedin Hoxha, rritjen e përkushtimit dhe të përgjegjshmërisë në punë të xhandarëve dhe oficerëve e shihte të

²⁶ *Po aty*, fl. 1.

²⁷ *Po aty*, F.152, V. 1925, D. 191, fl. 25, Telegram i KPFA drejtuar MPB, Tiranë, 27.3.1925.

²⁸ *Po aty*, fl. 52-55, 63, 73.

²⁹ *Po aty*.

lidhur drejtpërdrejt me shpërblimin financiar. Për këtë ai kërkonte ndryshimin e menjëhershëm në sistemin e pagesave dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre. Intendentëve apo aspirantëve, sipas tij duhej t'u hiqej e drejta për të tërhequr e për të shpërndarë fondin e pagave për xhandarët. "Vërehej rëndom, theksonte ai, se ata fondin e pagave nuk ua shpërndanin xhandarëve për disa muaj, e më pas ua pjesëtonin sipas dëshirës, dikujt 10, dikujt 20, dikujt asgjë."³⁰

Bashkëpunimi i Ahmet Zogut me oficerët britanikë për reformimin e xhandarmërisë

Për të shpëtuar vendin nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhej, ku sundonte anarkia, pasiguria e jetës dhe e pronës për shkak të bandave keqbërëse që kishin lulëzuar në vend, mungesa e zbatimit të ligjit etj., A. Zogu, qysh në fillim të vitit 1925, mendoi për organizimin e një xhandarmërie sa më efikase e profesionale që të ishte e aftë për t'iu përgjigjur detyrave që shtroheshin para saj. Për këtë ai gjykoi të sillte një trupë oficerësh të huaj për t'u vënë në shërbim të shtetit shqiptar. "Ai (A. Zogu - F. M.), thekson në kujtimet e tij W. F. Stirling, arriti të kuptojë se për të arritur sigurinë e vendit, ishte e nevojshme krijimi i një xhandarmërie të nivelit të lartë".³¹ Këtë çështje Zogu e diskutoi me kolonelin anglez, Stirling dhe gjeti mbështetjen e mirëkuptimin e tij.

Për sigurimin e tyre, A. Zogu dhe koloneli Stirling, vendosën t'i drejtoheshin së pari qeverisë angleze. A. Zogu, përveç parapëlqimit për ushtarakët britanikë, shihte te Anglia një shtet pa interesa politike dhe territoriale ndaj Shqipërisë dhe shpresonte të siguronte përkrahjen e saj për Shqipërinë.³² Kështu në janar 1925, Stirling u nis për në Angli, ku paraqiti propozimin e qeverisë shqiptare në War Office.³³ Qeveria angleze, me ndrojtjen se kjo mund të acaronte marrëdhëniet me Italinë, e cila e konsideronte Shqipërinë zonë të influencës së saj, vendosi të mos i jepte mbështetje zyrtare skemës së Stirling-ut. Nga ana tjetër, Chamberlain e vlerësoi si të domosdoshëm dërgimin e oficerëve britanikë në Shqipëri pasi dy fqinjët e saj, Italia dhe Jugosllavia, ishin deklaruar për

³⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 191, fl. 21, Njoftim i nënprefektit, A. Hoxha, drejtuar MPB, Peshkopi, 12.3.1925.

³¹ W. F. Stirling, *Safety Last...*, f.132.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*.

pavarësinë e Shqipërisë, dhe asnjëra nuk do të lejonte tjetrën të pretendonte për pozitë mbizotëruese aty. “Ata (shqiptarët - F.M), theksonte Chamberlain, padyshim kanë të drejtë që, për një xhandarmëri të tillë, absolutisht të kërkojnë oficerë të huaj ... Nga pikëpamja e kualifikimit nuk dyshoj që shqiptarët kanë të drejtë të arrijnë në përfundimin që ata duhet të jenë ose oficerë britanikë ose asgjë tjetër”³⁴. I gjendur përballë qëndrimit kundërshtues të Musolinit, Chamberlain bëri përpjekje për ta bindur Stirling, që të tërhiqej nga plani i tij, por koloneli u tregua i vendosur dhe iu përgjigj: “Në Shqipëri çështja e krijimit të një qeverie dhe administrate të qëndrueshme është çështje jete a vdekjeje. Kjo skemë është shansi i saj i fundit. Nëqoftëse dështon, rregulli nuk do të mbahet, qeveria do të humbë kredibilitetin dhe seria e lëvizjeve revolucionare do të fillojë përsëri. Kjo krizë do të çonte vetëm në copëtimin e Shqipërisë, e cila do t’i sillte probleme shumë më serioze diplomacisë angleze se sa një zënkë me Italinë, mbi xhandarmërinë”³⁵. Qeveria angleze pranoi që Stirling, si i punësuar privatisht në shtetin shqiptar, t’i rekrutonte oficerët në mënyrë të pavarur. Pavarësisht qëndrimit të shtetit të tij, Stirling përzgjodhi bashkëpunëtorët e u kthye në Shqipëri në prill 1925. Foreign Office i kërkoi diplomatit anglez në Durrës, Eyres që të bënte me dije A. Zogun, për çfarë kishte ndodhur midis tyre dhe Musolinit për çështjen e rekrutimit të ish oficerëve britanikë për xhandarmërinë shqiptare. Ai i kërkoi Zogut që të shtynte përkohësisht zbatimin e këtij plani. Por, Zogu ishte i vetëdijshëm për qëndrimin e Italisë e cila, edhe pas ardhjes së oficerëve anglezë, kërkoi largimin e tyre nga Shqipëria. Prandaj iu përgjigj Eyres-it se “nuk kishte alternativë tjetër racionale përveçse skemës së tij për xhandarmërinë”³⁶.

Zogu e përgëzoi kolonelin Stirling për vendosmërinë e tij dhe mirëpriti gatishmërinë e oficerëve ekspertë britanikë, me të cilët në maj të vitit 1925, lidhi kontratat.³⁷ Ata u caktuan në funksionin e inspektorit dhe ndihmësinspektorit pranë komandave të zonave³⁸. Në krye të tyre,

³⁴ Pranvera Dibra, *Shqipëria dhe diplomacia angleze në vitet 1919-1927*, Tiranë: “Neraida”, 2005. f. 291.

³⁵ *Po aty*, f. 297.

³⁶ *Po aty*, f. 300.

³⁷ *AQSH*, F. 149, V. 1925, D. II-181, fl.1, Telegram i inspektorit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë drejtuar Kryesisë së Republikës, Tiranë, 4.5.1925.

³⁸ *Po aty*, F. 149, V. 1925, D. II-181, fl.1; *po aty*, F. 152, D. 338, fl. 3, Njoftim i MPB drejtuar prefekturës Shkodër, Tiranë, 25.5.1925. Mbi emërimet e 9 oficerëve

inspektor i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, u caktua koloneli W. F. Stirling.

Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë, në bashkëpunim me inspektoratin britanik, të cilët të mbështetur në eksperiencën më të përparuar në këtë fushë, përgatitën dy rregulloret e plota, në bazë të të cilave do të vepronte xhandarmëria. Njëra përcaktonte marrëdhëniet e xhandarmërisë me sektorë të ndryshëm të administratës dhe tjetra, mënyrën e riorganizimit të saj.³⁹ Pikat 1, 2, 3, të rregullores për xhandarmërinë, lanë përkohësisht të pandryshuar ndarjen e forcave të xhandarmërisë në dy kategori dhe administrimin e saj në katër zona. Qendra e KPXH ishte Tirana, ndërsa katër komandat e zonave ishin: Tirana, Shkodra, Peshkopia dhe Gjirokastra. Oficerët e huaj, sipas rregullores, u caktuan inspektorë dhe ndihmës inspektorë pranë komandave të zonave. Në nenet e rregullores vërehet se inspektorëve dhe veçanërisht inspektorit të Përgjithshëm, u njiheshin kompetenca më të gjera krahasuar me Komandantin e Përgjithshëm të Xhandarmërisë dhe komandantët e zonave. Veçanërisht neni 7 i rregullores, i njihete Inspektorisë së Përgjithshme, kompetenca të gjera për ngritjen e një xhandarmërie të aftë si dhe përcaktonte qartë raportet e inspektorëve me komandat përkatëse. Sipas rregullores, KPXH duhej të zbatonte të gjitha rekomandimet e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe atyre të zonave dhe, në mungesë të tyre ato të ndihmësinspektorëve. Inspektori i Përgjithshëm kishte kompetenca mjaft të gjera.⁴⁰ Ai ishte përgjegjës për të gjitha çështjet e disiplinës, gradimit, shtimit të fuqisë së xhandarmërisë. Edhe KPXH kishte detyrimin dhe të drejtën të merrej me këto çështje por, para se të vendoste, ajo duhej të merrte mendimin e inspektorit të Përgjithshëm dhe së bashku të paraqiteshin para Kryetarit të Republikës. Emërimet e shpejta të oficerëve të xhandarmërisë deri në prill të vitit 1925, u quajtën provizore. Inspektorit të Përgjithshëm dhe KPXH, neni 7 i rregullores, u njihete të drejtën që gjatë ngritjes dhe strukturimit të xhandarmërsë, t'i propozonin Kryetarit të Republikës, shkarkimin e tyre.

anglezë si inspektorë dhe ndihmësinspektorë; *po aty*, fl. 4, Njoftohet se kolonel Stirling ishte zgjedhur inspektor i Përgjithshëm i Xhandarmërisë.

³⁹ *Po aty*, F. 253, V. 1925, D. 329, fl. 4, Rregullore e MPB drejtuar prefekturës Durrës, Tiranë, 20.5.1925; *Ligje, dekretligje, rregullore për vitin 1925*, Tiranë, 1938, f.165-169.

⁴⁰ *Po aty*, neni 7.

Kjo u krijonte mundësi inspektorëve anglezë për të vepruar lirshëm, për të përzgjedhur e për të sjellë në xhandarmëri kuadro të aftë e për të larguar të gjithë ata që kishin përfituar padrejtësisht nga situata politike e fillimit të vitit 1925. Inspektori i Përgjithshëm dhe KPXh, ishin përgjegjës para Kryetarit të Shtetit për sigurimin e rendit e qetësisë në vend.

Xhandarmëria, për realizimin e detyrave, duhej të bashkëpunonte edhe me degë të tjera të administratës. Këto marrëdhënie u përcaktuan në rregulloren “Mbi marrëdhëniet e xhandarmërisë me degët e tjera të administratës”.⁴¹ Në nenin 1 të saj, theksohej se KPXH ishte kompetente në çështje që i përkisnin detyrës ushtarake si gradim, emërim, disiplinë etj. Por në këtë nen përcaktohej se KPXH, para çdo veprimi, duhej të merrte mendimin e inspektorit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë, i cili ishte përgjegjës para Kryetarit të Republikës.⁴² Kompetenca dhe rëndësia që ky nen i njihte inspektorit të Përgjithshëm, duke marrë parasysh mentalitetin e oficerëve shqiptarë, të cilët i jepnin më shumë rëndësi autoritetit të tyre se sa zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve, mund të çonte në mosmarrëveshje midis tij dhe KPXH. Për zgjidhjen e tyre, neni 2 i rregullores, sanksiononte si kompetente vetëm Kryesinë e Këshillit të Ministrave. Në këtë mënyrë ruhej dhe një farë pavarësie nga njëra tjetra midis KPXH-së dhe inspektorisë së Përgjithshme, e dëshiruar kjo prej oficerëve shqiptarë.

Gjatë veprimtarisë së saj dhe zbatimit të ligjeve, xhandarmëria duhej të bashkëpunonte me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa për çështjet që i përkisnin drejtësisë sipas procedurës penale, ajo duhej të lidhej me Ministrinë e Drejtësisë dhe, për përballimin e situatave të jashtzakonshme, ajo duhej të bashkëpunonte me strukturat e larta të pushtetit lokal. Në nenin 4 theksohej se, në ngjarje të jashtëzakonshme, titullarët më të lartë të qarkut, prefekti e nënprefekti, duhet të komunikonin vazhdimisht me rrethkomandat, të ndiqnin bashkërisht zhvillimin e situatave, t’u jepnin urdhra atyre për çfarë duhej të vepronin, por nuk kishin të drejtë të përziheshin në urdhrat e dhëna nga komandat e

⁴¹ AQSH, F. 152, V. 1925, D. 334, fl. 24, Rregullore mbi marrëdhëniet e xhandarmërisë me degë të tjera të administratës. Shih në: *Ligje, dekretligje e rregullore të vitit 1925...*, f. 165.

⁴² *Po aty.*

ndryshme të xhandarmërisë.⁴³ Një përcaktim i tillë ruante pavarësinë e këtyre institucioneve për të mos ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit. Prefekti e nënprefekti mbanin përgjegjësi për sigurimin e rendit e të qetësisë në njësinë administrative ku ata drejtonin. Për këto probleme komandat e zonave e të rretheve zbatonin urdhrat e tyre.⁴⁴

Mbështetur në informacionet mbi veprimtarinë e xhandarmërisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1925, A. Zogu e vlerësoi dhe e konsideroi situatën si shumë shqetësuese për shkak se ajo mund të ndikonte në rritjen e pakënaqësisë në vend. Ai u angazhua drejtpërdrejtë në marrjen e masave të menjëhershme për uljen e veprimeve antiligjore në xhandarmëri, për forcimin e disiplinës dhe për riorganizimin e saj. Për këtë ai u mbështet dhe forcoi bashkëpunimin me oficerët britanikë. Pozicioni e kompetencat që atyre u ishin njohur, si dhe të qenit jashtë lidhjeve shoqërore, miqësore e fisnore, do të ndihmonin në evidentimin drejt të problemeve, në marrjen e masave të nevojshme ndaj përgjegjësve dhe veprimeve të tyre të paligjshme. Për këtë A. Zogu, autorizoi inspektorin Stirling të kryente inspektimin e përgjithshëm e të hollësishëm në prefekturat e Shkodrës, Korçës e Dibrës e t'ia raportonte. Në të njëjtën kohë, ai u kërkoi autoriteteve lokale të këtyre zonave, t'i nënshtroheshin kontrollit dhe të mos i nxirrnin pengesa, deri në mbarim të punës.⁴⁵

Caktimi i oficerëve britanikë si inspektorë dhe zëvendësinspektorë dhe veçanërisht dhënia e kompetencave të gjëra në marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes në xhandarmëri, bëri që te oficerët e lartë të xhandarmërisë shqiptare të manifestoheshin shenja ftohtësie dhe xhelozie, që u dëshmuuan në mungesën e gatishmërisë për bashkëpunim. KPXh-ja nuk e priti mirë dhënien e kompetencave inspektorëve britanikë në të gjithë spektrin e veprimtarisë të strukturave të xhandarmërisë dhe në marrëdhënie me Kryetarin e Republikës. Madje KPXh, marrjen e vendimeve dhe dhënien e urdhrave, pa marrë më parë pëlqimin e inspektorit britanik, e konsideroi prekje të dinjitetit dhe ulje për ta. Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, R. Dibra, i kërkoi kryetarit të shtetit kufizimin e veprimtarisë të inspektorëve të huaj, me justifikimin

⁴³ *Po aty*, neni 4.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *AQSH*, F. 152, V. 1925, D. 334, fl. 78, Urdhër për Stirling nga MPB, Tiranë, 7.8.1925.

për të mos dalë jashtë “çështjet rezervate të shtetit” (për të ruajtur sekretin). Sipas tij, ata duhej të angazhoheshin vetëm në çështje të organizimit të xhandarmërisë.⁴⁶ Madje, ai shkoi edhe më tej. Duke shfrytëzuar ndjeshmërinë që kishte Zogu për figurën morale të ushtarakut, e informoi atë se oficerët anglezë nuk tregonin seriozitetin e duhur në punë dhe manifestonin në ambiente publike sjellje të pahijshme. Ai sugjeronte që të rishikohej rregullorja e re e miratuar në maj 1925, për të riparë edhe një herë detyrat, përgjegjësitë dhe kopetencat e inspektoratit, të krijohej një komision ekspertësh për hartimin e një rregulloreje të re ose të kthenin në fuqi rregulloren e mëparshme, ku të përcaktoheshin qartë marrëdhëniet midis KPXH-se dhe inspektorëve të huaj.⁴⁷

E njëjta frymë ndaj oficerëve të huaj ishte përcjellë edhe te komandantët e zonave, e cila reflektohej në prirjen për të penguar veprimtarinë e inspektorëve të huaj gjatë ushtrimit të kontrolleve. Komandanti i zonës së Shkodrës M. Bushati, duke i konsideruar veprimet e inspektorëve si ndërhyrje në punët e brendshme, i kërkonte prokurorit të mos bashkëpunonte me ta për të mbledhur fakte për çështjet që atij i interesonin.

Megjithë pengesat dhe përplasjet që oficerët britanikë hasën në autoritetet e xhandarmërisë, ata, duke e konsideruar veten nëpunës të shtetit shqiptar, vazhduan të kryenin detyrën që u ishte ngarkuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Në informacionet që ata u dërgonin instancave më të larta të shtetit dhe personalisht A. Zogut, ngrinin probleme, evidentonin të meta dhe bënin propozime të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen në forcat e xhandarmërisë. Gjatë kontrolleve, inspektorët britanikë konstatuan shkelje të ligjeve nga strukturat e xhandarmërisë. Raportimet e tyre, për gjendjen reale në vend dhe në veçanti për veprimet e xhandarmërisë, nuk u pëlqenin ushtarakëve të lartë shqiptarë. Inspektori i Shkodrës, qëndrimin e sjelljen e tyre, i konsideronte si përpjekje për të mbuluar të vërtetën. Këtë nënvizonte ai në relacionin që i drejtonte inspektorit Stirling ku theksonte se: “Fshehja e gjendjes së rëndë në burgun e Shkodrës nuk mund t’i bënte tjetër, përveçse dëm qeverisë, shërbëtor i së cilës unë jam. Nëse veprimet e mia do të pengohen dhe në qoftëse qeveria dëshiron të vazhdojë me gjendjen

⁴⁶ *Po aty*, V. 1925, D. II-181, fl. 30, Shkresë e KPXH drejtuar Kryesisë së Republikës, Tiranë, 11.06. 1925.

⁴⁷ *Po aty*.

e tashme, jam gati të tërhiqem”.⁴⁸ Të njëjtin shqetësim ngrinte edhe inspektori E.S. Palmer, gjatë raportimit për zonën që mbulonte. Ai theksonte se për gjendjen e krijuar dhe pakënaqësinë e madhe që ishte përhapur në popullsinë e këtij rrethi (Pukë), shkaktarë ishin edhe veprimet e rrethkomandës, e për këtë ajo duhej të mbante përgjegjësi.⁴⁹

Fryma jobashkëpunuese midis oficerëve shqiptarë dhe atyre të huaj, pengonte ecjen e punëve në xhandarmëri dhe reformimin e saj. Për të shkrirë “akullin” midis tyre dhe në të mirë të punës, majori Ruper i drejtoi një letër A. Zogut ku theksonte: “Kam zbuluar se këto ndjenja manifestohen ndër komandat e larta të xhandarmërisë e cila është rrjedhojë e emërtimeve më të larta dhe e kompetencave më të mëdha që u janë dhënë oficerëve britanikë, gjë që ka prekur sedrën e oficerëve shqiptarë e cila nuk i lejon ata të marrin urdhra nga të huajt”.⁵⁰ Për të krijuar marrëdhënie miqësore dhe të pranueshme midis tyre, ai i bëri A. Zogut tre propozime: së pari, të ngriheshin klube të përbashkëta ku ata të njiheshin me njëri-tjetrin dhe të krijonin shoqëri të vërtetë. Në këtë mënyrë do të qëndronin më shumë bashkë, do të shfaqnin mendime dhe do të shkëmbenin përvojën e tyre dhe jo të kufizoheshin vetëm në veprime zyrtare të dhënies së rekomandimeve dhe komandave.⁵¹ Së dyti, iu kërkua që shkresat e KPXh-së dhe inspektorit të Përgjithshëm të mos kishin vlerë pa nënshkrimin e secilit prej tyre tek shkresat e njëri tjetrit. Kjo do të bënte që të dy palët të ishin në pozita të barabarta dhe inspektorëve të huaj të mos u fshihej më informacioni nga oficerët shqiptarë.⁵² Së treti, në krye të KPXh-së rekomandonte emërimin e një komandanti dashamirës e miqësor ndaj inspektorëve të huaj, pasi kështu do të ndryshonte edhe qëndrimi i oficerëve të rinj në strukturat vartëse.

Kontradiktat midis tyre u zgjeruan më tepër, pasi në informacionet e britanikëve pasqyrohej e vërteta, zbuloheshin dobësitë e punës në strukturat e xhandarmërisë dhe bëheshin propozime konkrete me synimin

⁴⁸ *Po aty*, F. 152, V. 1926, D. 830, fl. 29, Relacion i inspektorit të zonës së Veriut, inspektorit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë, Shkodër, 28.08.1926.

⁴⁹ *Po aty*, F. 144, V. 1927, D. 14, fl. 11, Informacion i inspektorit të Xhandarmërisë së zonës së Veriut drejtuar presidentit të Republikës, Pukë, 24.2.1927.

⁵⁰ *Po aty*, F. 149, V. 1926, D. II-190, Letër e inspektorit të Xhandarmërisë drejtuar kryetarit të Republikës Tiranë, 7.6.1926.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*.

për të përmirësuar punën e saj. Relacionet e tyre i shërbyen Presidentit të Republikës për të njohur gjendjen e vendit e të xhandarmërisë dhe për marrjen e masave të duhura.

Nga ana e tyre, autoritetet e xhandarmërisë shqiptare, paraqitnin vazhdimisht justifikime për çështjet e shtruara prej inspektorëve, nuk i pranonin vërejtjet, kundërshtonin masat e propozuara prej tyre për të ndëshkuar fajtorët duke i marrë ata në mbrojtje. Më e theksuar kjo ishte te KPXH-ja, gjë që pengonte shëndoshjen e gjendjes në xhandarmëri. Por Zogu e pati disi të vështirë për të shmangur R. Dibrën nga posti i komandantit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë, pasi ky i fundit kishte kontribuar në rikthimin e tij në Tiranë. Prandaj me të drejtën që i jepte Statuti Themeltar i Shtetit, e mori në dorë vetë situatën dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme e me Ministrinë e Drejtësisë nxorri dekrete, vendime e udhëzime për vendosjen e disiplinës në xhandarmëri. Ai kërkoi ndëshkimin e menjëhershëm të xhandarëve e sidomos të vullnetarëve, të cilët me sjelljet e tyre, mund të çonin në situata të papritura e të rrezikshme dhe çuarjen para drejtësisë të oficerëve e xhandarëve që kishin kryer vepra të paligjshme, duke i dënuar pa mëshirë.⁵³ Kështu u liruan nga detyra disa oficerë e xhandarë në rrethet Berat, Vlorë, Krujë, Gjirokastrë. U hap procesi gjyqësor për kapiten Jusuf Lohjen, i cili akuzohej për abuzime me detyrën, marrje ryshfeti dhe mbështetje të kontrabandës.⁵⁴ Në prill të atij viti, me dekret të Presidentit u çua para organeve të drejtësisë toger A. Botku, i cili kishte keqtrajtuar nëpunësin e shtetit, kryeplakun e Peqinit, Alush Bedallin.⁵⁵ Ajo çka bie në sy, është kujdesi që tregonte Zogu, që masat e dënimit e ushtarakëve të vërtetoheshin, të argumentoheshin dhe të mbështeteshin në ligj. Kështu për të verifikuar sjelljen e nënoficerit të akuzuar, tetarit Haki Kullësi, fajësimi i të cilit ishte kundërshtuar nga KPXH-ja, Zogu dërgoi në Mallakastër, inspektorin e Përgjithshëm Stirling dhe përfaqësues të MPB, të cilët pasi verifikuan se akuza ndaj tetarit ishte e saktë, i bënë me dije KPXH-së se sjellja e tij ishte në kundërshtim me programin e qeverisë e cila kërkonte që të mbretëronte

⁵³ *Po aty*, F.152, V. 1927, D. 28, fl. 2, Kryesia e Republikës drejtuar MPB, Tiranë, 12.2.1927. Me shënimin: T'u dergohet Prefekturës së Shkodrës dhe nën/prefekturave të Malsisë Pukës, Mirditës, Dukagjinit etj.

⁵⁴ *Po aty*, F. 152, V. 1927, D. 336, fl.14, Dekret i Presidentit të Republikës, Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 18.1.1927.

⁵⁵ *Po aty*, f. 79.

ligji dhe ishte e interesuar që shtetasit të mos mundohen e ndëshkohen pa u mbështetur në ligj.⁵⁶ Interesimi i Zogut për forcimin e xhandarmërisë nëpërmjet forcimit të disiplinës duke vepruar vetëm në zbatim të ligjeve të shtetit dhe rregulloreve përkatëse, ka qenë i vazhdueshëm. Kjo dëshmohet edhe në letrën përcjellëse të dekretit për emërimin e Abdurrahman Dibrës si ministër i Punëve të Brendshme, ku midis të tjerave e porosiste për kujdesin dhe angazhimin që duhej të tregonte për përmirësimin e disiplinës e mbarëvajtjes në administratën shtetërore, e veçanërisht në forcat e xhandarmërisë si organi i rëndësishëm ekzekutiv i qeverisë. Të ndëshkonte çdo sjellje të keqe të xhandarëve “në mënyrë që të mos ndigjohet as më i vogli ankim nga populli, që çdo shtrëngim (dhunë) nga ana e xhandarëve, të ketë dënimin e merituar”.⁵⁷

Krahas masave disiplinore e ligjore, u morën edhe masa me karakter organizativ, që synonin përmirësimin e veprimtarisë së strukturave të xhandarmërisë. Në prill 1926, në kuadër të reformës në Ministrinë e Financave, kjo Ministri, i paraqiti Kryesisë së Republikës rregulloren e arkave (zyrave të financave) të ushtrisë e xhandarmërisë. Ky ishte një hap shumë pozitiv i cili ndërmerrej për herë të parë në forcat e armatosura. Ato do të ndikonin në administrimin dhe kontrollimin më të mirë të buxhetit të tyre nga ky dikaster, do të disiplinonin dhe do të ndiqnin shpërndarjen e fondit të pagave dhe veprimeve të tjera financiare.

Në rregullore përcaktohej që pranë KPFA-së e KPXH-së, do të formohej nga një zyrë kontabël me detyrë kontrollimin e buxhetit të këtyre komandave në përputhje me ligjet e shtetit dhe të financave. Personeli i këtyre zyrave varej e paguhej nga Ministria e Financave. Çdo veprim financiar që u përkiste këtyre dy forcave do të kryhej nga këto zyra. Kryetari i intendencës dhe llogaritari ishin përgjegjës para Ministrisë së Financave, për shpenzimet e fondeve. Në komisione vetëm llogaritari kishte të drejtën e vetos për të anuluar çdo tender ku vëreheshin parregullsi. Për çdo veprim financiar që kryhej në ushtri e xhandarmëri, ai informonte Ministrinë e Financave. Në disa nene të rregullores përcaktohej mënyra e disiplinimi i dhënies së pagave oficerëve e xhandarëve. “Çdo pagesë, theksohej në rregullore, do të bëhej

⁵⁶ *Po aty*, f. 39, Shkresë e MPB drejtuar KPXH, Tiranë, 13.3.1927.

⁵⁷ *Po aty*, F. 149, V. 1927, D. I-863, fl. 7, Letër e kryesisë së Republikës drejtuar A.Dibrës, Tiranë, 12.2.1927.

në prezencë të llogaritarit dhe të nënshkruhej në listën e arkës”.⁵⁸ Kjo procedurë i jepte fund praktikave dhe mentalitetit të vjetër në shpërndarjen e pagave, mënjanonte intendentin dhe siguronte pagesën e rregullt të xhandarëve. E njëjta procedurë do të zbatohet në të gjithë sistemin e administratës shtetërore. Qëllimi ishte të vihej nën kontrollin e Ministrisë së Financave i gjithë buxheti i shtetit, për të mënjanuar abuzimet që ishin vënë re deri atëherë.

Masat e marra gjatë viteve 1925-1927, bënë të mundur konsolidimin e strukturës së xhandarmërisë, rritjen e përgjegjshmërisë së kuadrove dhe komandave në kryerjen e detyrave, përmirësimin e disiplinës në efektivët e saj etj. Këto arritje përbënin një bazë për reformimin e mëtejshëm të xhandarmërisë. Për këtë, KPXH-ja në bashkëpunim me Inspektorinë e Përgjithshme, në maj 1927, hartuan dhe paraqitën projektligjin për strukturën e re organike të xhandarmërisë⁵⁹. Hartimi i këtij projektligji u mbështet në studimin përparës nga kolonel Stirling në fillim të vitit 1926, me titull “Mbi çështje të kuadrit në xhandarmëri”.⁶⁰ Për të ulur shpenzimet e panevojshme në këtë sektor, ai propozoi që 24 oficerë të listës së rezervës, të cilët ishin pa shërbim por mbanin grada e merrnin paga vetëm për “arsye politike”, të hiqeshin nga listat e pagesave dhe fondi i tyre t’i kalonte zyrës sekrete në MPB. Gjithashtu, ai propozonte që në komandat drejtuese të caktoheshin oficerë sipas gradës ashtu siç parashikonte ligji. Sipas tij, komandantët e zonave me forca prej 1000 xhandarësh, për mungesë oficerësh me gradën major e nënkolonel që e përmbante funksioni, nuk mund të drejtoheshin nga oficerë me gradë më të ulët se kapiten, pasi ata do të kishin në vartësi oficerë më të vjetër e më me eksperiencë. Në të kundërt do të krijoheshin probleme në hierarkinë ushtarake.⁶¹

Sipas projektligjit struktura e re përmbante: Inspektorinë e Përgjithshme. Meqënëse Stirling u emërua Inspektor i Përgjithshëm i të gjithë administratës (përveç asaj të Drejtësisë), në vend të tij u zgjodh

⁵⁸ *Po aty*, F. 149, V. 1926, D. II-187, fl. 6, Ministria e Financave. Rregullore e arkave të ushtrisë xhandarmërisë, Kryesisë së Republikës, Tiranë 21.4.1926.

⁵⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1927, D. 96, fl. 130, Kuadri i ri i Xhandarmërisë, miratuar nga Kryesia e Republikës, Tiranë, 19 maj 1927.

⁶⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1926, D. 181, fl.1-4, Studim i inspektorit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë, për çështje të kuadrit në Xhandarmëri drejtuar MPB, Tiranë, 2.2.1926.

⁶¹ *Po aty*.

Gjeneral Major Sir Jocely Perscy, u emërua ndihmës i inspektorit të Përgjithshëm majori Han, katër inspektorë, majori Brok, H, Jekson, S. Riney, E.I Palmer dhe katër përkthyes shqiptarë: Sotir Harito, Andon Gjergji, Palok Shkjezi, Rexhep Meto, Vasil Zisi.⁶²

Me këtë rast A. Zogu largoi nga detyra e komandantit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë R. Dibrën dhe në vend të tij emëroi deputetin e Elbasanit, Kasem Sejдини. Në përbërje të KPXh-së ishin: 44 oficerë dhe 16 xhandarë. Në projektligj saktësohej edhe organika e shkollës së xhandarmërisë me qendër në Shkodër. Komanda e shkollës përbëhej nga komandant Akif Përmeti, adjutanti, mjeku, tre mësues drejtësie dhe personeli oficer e nënoficer për stërvitjen, ruajtjen dhe shërbime të tjera në shkollë. I gjithë efektivi i saj arrinte deri në 180 vetë.

Ndryshime u bënë edhe në shtrirjen territoriale të njësive të xhandarmërisë. U shkrinë zonëkomandat dhe u krijuan nëntë qarkkomanda. Qarkkomandat ishin: Shkodra, me komandant kapitenin e klasit II, H. Dema, Korça, me komandant kapiten i klasit II, Viktor Shantoja, Gjirokastra, me komandant kapiten i klasit II, Qamil Boksi, Elbasani, me komandant kapiten i klasit II, Tasim Bishqemi, Berati, me komandant toger Idris Kuka, Vlora, me komandant toger Sul Zdrava, Dibra, me komandant toger Selim Libohova, Tirana, me komandant kapiten i klasit II, Fiqiri Dine, Lezha, me komandant kapiten i klasit II, Qerim Nasufi. Në vartësi të qarkkomandave ishin rrethkomandat. Një kompani shëtitëse me komandant Murat Kaloshin u vendos në Bicaj në prefekturën e Kosovës, me 94 xhandarë.⁶³ Fuqia e xhandarmërisë arrinte deri në 2300 vetë.

Projektligji iu dërgua edhe organeve të pushtetit lokal për t'u njohur e për të dhënë mendime. Prefekti i Shkodrës në vërejtjet e tij propozonte që, Lezha të mos shkëputej nga qarkkomanda e Shkodrës siç parashikohej në projektligj pasi tradicionalisht ajo kishte qenë pjesë e saj⁶⁴ dhe kërkoi nga MPB, që komanda e qarkut nuk duhej të lidhej

⁶² *Po aty*, F. 152, V. 1927, D. 96, fl. 130, Kuadri i ri i Xhandarmërisë. Miratuar nga Kryesia e Republikës, Tiranë, 19.05.1927.

⁶³ *Po aty*, F. 152, V. 1927, D. 754, fl.19, Telegram i prefekturës së Kosovës drejtuar MPB, Kukës, 19.8.1927.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 9, Telegram i prefektit të Shkodrës, S.Leskoviku, drejtuar MPB, Shkodër, 5.8.1927; *po aty*, fl. 16, Kryesia e Republikës drejtuar MPB. Ligj mbi suprimimin e komandës së xhandarmërisë të qarkut Lezhë, Tiranë, 16.11.1927.

drejtpërdrejt me MPB-në ashtu siç parashikohej, por duhej të komunikonte së pari me prefekturën si autoriteti më i lartë i qarkut.⁶⁵

Organizimi i ri i xhandarmërisë realizoi shkrirjen e kompanive shëtitëse. Për nevojat e gatishmërisë u ngrit një detashment lëvizës që do të qëndronte si rezervë e KPXH-së për ta përdorur në raste të jashtëzakonshme.⁶⁶ Me rritjen e efektivave të xhandarmërisë në disa qarqe, u ndje nevoja për oficerë. Prandaj u dha porosia të merreshin përsëri në shërbim oficerë të aftë prej atyre që u liruan në fillim të vitit 1925. Për t'i prerë rrugën abuzimit dhe për të ulur sado pak korrupsionin, MPB i kërkoi KPXH-së të merrte vendime për të ndaluar marrjen në shërbim të xhandarëve e graduatëve (nënoficerëve) në ato qarqe ku si komandantë ishin persona me të cilët kishin lidhje fisnore.⁶⁷ Zogu mbështeti vizitën e komandantit Kasem Sejдини në disa shtete të rajonit si Itali, Bullgari, Turqi e Greqi e cila do të shërbente për të vendosur kontakte bashkëpunimi dhe për t'u njohur me përvojën e punës e të drejtimit të xhandarmërisë së këtyre vendeve e për ta zbatuar atë sipas mundësive në xhandarmërinë shqiptare.⁶⁸

Riorganizimi, ligjet e vendimet e Këshillit të Ministrave, që u morën në zbatim të këtij procesi, shënuan përmirësime në forcimin e disiplinës në xhandarmëri, rritjen e efektivitetit të punës së saj, uljen e rasteve të abuzimeve, të korrupsionit, sjelljeve të paligjshme në popull si dhe rritjen e ndëshkueshmërisë për shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve ushtarake.⁶⁹ Po kështu u përmirësuan marrëdhëniet jo vetëm midis hallkave të brendshme të kësaj strukture por dhe midis saj dhe degëve të tjera të administratës shtetërore, gjë që ndikoi në përmirësimin e rendit e të qetësisë në vend.

Merita kryesore i takon drejtimit të kualifikuar të oficerëve britanikë, të cilët pavarësisht frymës jobashkëpunuese të ofruar nga oficerët drejtues të xhandarmërisë për shkak të bajraktarizmit, konservatorizmit, mungesës

⁶⁵ *Po aty*, f.11.

⁶⁶ *Po aty*, V. 1927, D. 754, fl. 16, Vendim nr. 449 i KM, Tiranë, 28.10.1927; W. F. Stieling, *Safety last...*, f. 141.

⁶⁷ *AQSH*, F. 149, V. 1927, D. I-856, fl. 118, Telegram i MPB drejtuar KM, Tiranë, 4.10.1927.

⁶⁸ *Po aty*, F.152, V. 1928, D. 231, fl. 14, Telegram i KPXH, K. Sejдини, drejtuar KPFA-së, Tiranë, 1.7.1928.

⁶⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 374, fl. 44, Vendim i KM nr. 368, MPB, Tiranë, 22.6.1928; *po aty*, fl. 24-26, 32, KPXH drejtuar MPB, Tiranë, 17.2.1928.

së përvojës të manifestuar prej tyre, punuan me durim në kryerjen e misionit për të cilën shteti shqiptar i kishte thirrur. Me këmbëngulje i kapërcyen ato, duke sjellë dhe aplikuar përvojën e përparuar të vendit të tyre në organizimin dhe funksionimin e forcave të xhandarmërisë shqiptare.

Vullneti e përkushtimi i tyre, gjeti mbështetjen e gjithanshme të Ahmet Zogut. Me kompetencat që u njohu, lehtësitë që u krijoi në ushtrimin e detyrës, si dhe me vendosjen e komunikimit e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me ta, arriti të realizojë reformimin e xhandarmërisë duke e kthyer atë nga një forcë problematike, në një forcë ekzekutive të qeverisë, në ruajtëse të rendit dhe qetësisë publike.

S u m m a r y

THE REORGANIZATION OF THE ALBANIAN GENDARMERIE (1925-1928)

This paper deals with the reorganization of the Albanian gendarmerie from 1925 to 1928. During this time it was made an important progress in the reformation and consolidation of the state institutions, the implementation of the law in everyday life and in this context the gendarmerie received a special attention, too.

Based on archival documents and published sources, this paper makes an overview of the situation in the Albanian gendarmerie in 1925 and the issues it encountered during this time. Moreover, there are analyzed the factors that limited and restricted the gendarmerie's activity and prevented it from being stronger although A.Zogu insisted on having British officers sent from Britain to help in its reorganization. In addition, it is highlighted the support that A. Zogu provided for the foreign officers, the competences they were given, the direct communication and collaboration he had with them and the General Headquarters of the gendarmerie, actions that made possible the overcoming of difficulties, gave shape to gendarmerie's structure, facilitated the draft and approval of laws and regulations thus creating the legal framework for its activity and the financial management of the gendarmerie's budget.

